



**UNIVERSITETI AAB**

ARENA E ARSIMIT BASHKËKOHOR  
PRISHTINË

---

**KODI I MIRËSJELLJES**

---

**Prishtinë,  
Maj 2006**



# UNIVERSITETI AAB

ARENA E ARSIMIT BASHKËKOHOR  
PRISHTINË

Kodi i Mirësjelljes së Universitetit AAB ka në themel parimet që rrjedhin nga Ligji mbi Arsimin e Lartë të Kosovës, Statuti i Universitetit AAB, si dhe rregulloret e Universitetit.

Kodi i Mirësjelljes (në tekstin e mëtejshëm “Kodi”) së Universitetit AAB miratohet nga Bordi i Universitetit. Ky kod është në funksion të Universitetit AAB si BPAL, me karakter mësimor, shkencor dhe artistik.

Parimet bazë të mirësjelljes dhe etikës në të cilat mbështetet procesi mësimor, shkencor e artistik janë:

## Neni 1

Personeli akademik i Universitetit AAB duhet të sillet në përputhje me standardet bashkëkohore të arsimit të lartë, si dhe brenda njohurive të tyre t’u përgjigjen studentëve të Universitetit me saktësi, qartësi dhe kulturë për çdo paqartësi, kërkesë apo pakënaqësi.

## Neni 2

Personeli akademik dhe ai i administratës duhet të respektojë dinjitetin e Universitetit dhe t’i eliminojë sjelljet që kanë ndikim negativ në imazhin e tyre të krijuar në shoqëri, ose që lëkundin besimin e studentëve ndaj Universitetit, të udhëhiqen nga profesionalizmi dhe ligji.

## Neni 3

Personeli akademik duhet të veprojë në pajtim me lirinë akademike duke respektuar shumëllojshmërinë e opinionëve, ideve e metodave, si dhe të stimulojë zhvillimin e mendimit kritik, të lirë e krijues.

## Neni 4

Të gjithë të punësuarit akademik dhe të administratës duhet të karakterizohen nga ndershmëria gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre, si dhe të udhëhiqen nga parimet e të së vërtetës shkencore dhe artistike.

## Neni 5

Të punësuarit e Universitetit AAB duhet të promovojnë dhe të ruajnë parimet e barazisë gjinore, etnike, raciale, klasore në strukturat e tyre.



# UNIVERSITETI AAB

ARENA E ARSIMIT BASHKËKOHOR  
PRISHTINË

## Neni 6

Të gjithë të punësuarit akademikë duhet t'i njohin dhe t'i zbatojnë aktet ligjore e nënligjore, urdhërat e rregulloret e Universitetit AAB, si dhe rolin dhe detyrën e hierarkisë akademike dhe administrative të zgjedhur, si dhe detyrat dhe të drejtat e çdo punonjësi.

## Neni 7

Puna e personelit akademik dhe të punësuarve të tjerë në Universitet duhet të zhvillohet në baza të parimeve të respektimit të ndërsjellë.

## Neni 8

Të gjithë të punësuarit, posaçërisht personeli akademik, duhet të punojnë për rritjen e besimit të studentëve, për mënyrën e administrimit të Universitetit, duke vënë të gjitha forcat dhe aftësitë e tyre në shërbim të këtij parimi. Ata duhet të jenë të hapur e transparentë me studentët duke i'u ofruar atyre informatat e nevojshme për njohuri sa ma cilësore e besim maksimal.

## Neni 9

Të gjithë të punësuarit e Universitetit duhet të kujdesën për pasurinë dhe për mirëmbajtjen e higjienës së lokaleve dhe pajisjeve të Universitetit.

## Neni 10

Të gjithë kandidatët me rastin e konkurimit në Universitetin AAB, janë të barabartë në konkurim sipas nenit 5 të këtij kodi.

## Neni 11

Të gjithë studentët që vijojnë procesin mësimor në Universitetin AAB, duhet t'i përmbushin obligimet e dala nga planet mësimore si dhe t'i zbatojnë me përpikëri rregullat e përcaktuara me aktet e Universitetit.

## Neni 12

Të gjithë studentët e Universitetit duhet t'i njohin dhe respektojnë të drejtat e personelit dhe të studentëve të tjerë, duke vepruar me respekt të ndërsjellë. Studentët e Universitetit janë të obliguar ta ruajnë rendin dhe dinjitetin e Universitetit.



# UNIVERSITETI AAB

ARENA E ARSIMIT BASHKËKOHOR  
PRISHTINË

## Neni 13

Studentët e Universitetit janë të obliguar që mos të kryejnë vepra të dëmshme dhe sjellje tjera kundërligjore të cilat dëmtojnë prestigjin dhe dinjitetin e Universitetit.

## Neni 14

Kodi i Mirësjelljes mund të ndryshohet sipas procedurave të parapara me Statut dhe Rregullore të Universitetit..

Universiteti AAB  
Prishtinë 2006